

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AGJENSINË E ZHVILLIMIT BUJQËSOR DHE RURAL, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Agjensinë e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, Tiranë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare dhe vlerësues*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 52, datë 30.05.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 31/8, datë 30.05.2014, i ka rekomanduar zj. Suela Popa, Drejtore e Agjensisë të Zhvillimit Bujqësor dhe Rural, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

Një përshkrim i objektit të përmirësimit ligjor.

Me VKM nr.1443, datë 31.10.2008 “*për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencisë për zhvillim bujqësor dhe rural (azhbr), si agjencia e pagesave*”, Pika 1 përcakton. *Krijimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (AZHBR), si agjencia e pagesave*, në kuptim të nenit 21 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “*Për bujqësinë dhe zhvillimin rural*”, i cili nga ana e tij përcakton se: “*Agjencia e pagesave*”:

1. *Agjencia e pagesave krijohet si ent publik buxhetor, me statusin e personit juridik, publik, në varësi të ministrit.*
2. *Agjencia e pagesave ka për detyrë: a) të vërë në zbatim masat e politikave bujqësore dhe të zhvillimit rural; b) të hartojë raportet dhe analizat, në përputhje me zhvillimin e bujqësisë; c) të organizojë ngritjen dhe funksionimin e sistemeve të integruara të administrimit dhe të kontrollit; ç) të organizojë ngritjen dhe zbatimin e sistemeve të informimit të tregut; d) të krijojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave të nevojshme; dh) të zbatojë masat e kontrollit dhe të auditit të brendshëm; e) të inspektojë fermerët dhe subjektet, që kanë përfituar nga fondet e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.*

-Mënyra e përdorimit të fondeve kundërparti nga AZHBR është “*veprimtari financiare*”, kjo sipas VKM nr. 239, datë 27.3.2013 “*Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit*” ku thuhet se; “*Këto fonde të përdoren nga AZHBR-ja në formën e kreditimit pa interes, me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, si dhe përpunimin e këtyre produkteve. AZHBR-ja mund të fillojë disa herë në vit procedurën e pranimit dhe vlerësimit të aplikimeve, deri në përdorimin e plotë të fondeve të mbledhura*”

Shprehja “*në formën e kreditimit pa interes*” është “*veprimtari financiar*”, si rrjedhojë “*të gjitha format e kredidhënies*” janë atribut i një “*Subjekt financiar jobankë*” dhe *AZHBR nuk është e licensuar*, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare, kjo në kundërshtim me ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “*Për bankat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; nenit 4, paragrafi 31 “*Subjekt financiar jobankë*” “*është personi juridik që licencohet nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 54 pika 2, “Veprimtari financiar konsiderohen: a) të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore” dhe nenit 126, “Subjektet financiare jobanka”.*

Rekomandimi:

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në funksion dhe kuptim të nenit 21 të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007 “*Për bujqësinë dhe zhvillimin rural*”, të kërkojë licensimin e Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare në përputhje me ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “*Për bankat në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar; nenit 4, paragrafi 31;

“Subjekt financiar jobankë” “është personi juridik që licençohet nga Banka e Shqipërisë, për të ushtruar një ose disa nga veprimtaritë financiare të përcaktuara në nenin 54 pika 2, “Veprimtari financiare konsiderohen: a) të gjitha format e kredithënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore e kredinë hipotekore; dhe nenit 126, “Subjektet financiare jobanka”.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE.

1-Të merren masa për të gjitha disbursimet (huatë) e dhëna për vitin 2012 e në vazhdim të kryhet verifikim në teren për ecurinë e investimit kryerjen e plotë të tij dhe efektivitetin e këtij disbursimi.

Menjëherë

2-Nga AZHBR të merren masa që përfituesit e (huasë) të cilëve u ka mbaruar afati një vjeçar i sigurimit të pronës nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi e cila është përdorur si kolateral të kryejnë sigurimin e pronës në përputhje me udhëzimin nr. 3, datë 16.2.2012 të ndryshuar pika 7/c, “Subjekti përfitues, bën sigurimin e pronës nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi”.

Menjëherë

3-Të merren masat organizative dhe kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, për 680 subjekte debitore për shumën **1,278,893,647 lekë.**

Menjëherë

4-Të merren masat organizative dhe të fillojnë procedurat ligjore për sekuestrimin e inventarëve ndaj 3 subjekteve debitorë “H...” sh.p.k., “Z...-P...” sh.p.k. dhe “Q...-S...” sh.p.k., të cilët nuk kanë likuiduar detyrimin në kundërshtim me kushtet e kontratës dhe të ligjit nr. 7850 datë 29.7.1999 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 476.

Menjëherë

5-Nga AZHBR të merren masat organizative për ndjekjen e realizimit të investimit duke verifikuar zbatimin në terren dhe në varësi të ecurisë së investimit të procedohet duke ndjekur rrugën e nevojshme administrative, si më poshtë:

-Për subjektin “B... Rr...” sh.p.k në shumën 4,002,000 lekë pasi sipas faturave tatimore janë realizuar pesë zëra punimesh të parashikuara në biznesplan në vlerën 10,998,000 lekë kur sipas biznes planit duhej të kryheshin edhe tre zëra të tjerë si pjesë e vlerës së financimit prej 15,000,000 lekë të cilat sipas raporteve të kontrollit rezulton se nuk janë realizuar dhe deri datën e auditimit nuk u paraqit raport kontrolli mbi realizimin e investimeve të pa përfunduara nga subjekti “B... R...” sh.p.k..

Likujdimi nga AZHBR është në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 16.2.2012, të ndryshuar pika 7, “Subjekti përfitues, paraqet dokumentacion të rregullt tatimor për investimin e kryer”, “çdo disbursim është në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit sipas fushës së investimit dhe shkallës përkatëse të financimit” dhe subjekti duhet të arkëtojë financimin e përftuar prej 4,002,000 lekë.

-Për subjektin “L...” sh.p.k në shumën 7,500,000 lekë financiar sipas faturave tatimore në shumën 15,000,000 lekë kur sipas raportit të kontrollit dt. 5.12.2012 thuhet “Nga krahasimi i biznesplanit të paraqitur me realizimin fizik të tij, investimi për ndërtimin e stallës së mbarështimit të dhive është në fazën e punimeve për përfundimin e skeletit me konstruksion metalik dhe vendosjen e paneleve sanduic. Investimi i “L...” sh.p.k. është në përputhje me biznesplanin por nuk ka përfunduar. Ju la detyrë dorëzimi i faturave tatimore për investimin e bërë në DEP”. Vlera e investimit sipas preventivave dhe ofertave të paraqitura nga aplikanti duhej të ishte në shumën rreth 41,000,000 lekë dhe deri datën e auditimit nuk u paraqit asnjë formular verifikimi ose raport kontrolli mbi realizimin e investimeve të pa përfunduara nga subjekti “L...” sh.p.k, sa më lart investimi është i papërfunduar, pa efektivitet, dhe likujdimi nga AZHBR është në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 16.2.2012 të ndryshuar pika 7, “Subjekti përfitues, paraqet dokumentacion të rregullt tatimor për investimin e kryer”, “çdo

disbursim është në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit sipas fushës së investimit dhe shkallës përkatëse të financimit”, si rezultat subjekti ka përfituar padrejtësisht financimin (huanë) prej (15,000,000 - 50% = 7,500,000 lekë) të cilën duhet ta arkëtojë.

-Për subjektin “A...” sh.p.k në shumën 35,000,000 lekë pasi ka përfituar (huanë) në kundërshtim me:

-Kushtin, qëllimin e fitimit të kredisë, huas për të cilin është shpallur fitues nga KVM të kredisë, subjekti “A...” sh.p.k, i cili përcakton se ... “Mbështetur në biznes planin e paraqitur nga subjekti, fitimi i huas për dhënien e kredisë subjektit “A...” sh.p.k, i korrespondon pikës tre, me emërtim “Pajisjet e katër linjave të përpunimit” me vlerë 722,000 euro, të fazës së parë (nëntor – gusht 2011) kundrejt vlerës prej 2,354,853 euro të investimit gjithsej, që realizohet në tre faza dhe që përfundon në muajin shtator 2012.

-Pikën 7/g “Disbursimi i huas” të Udhëzimit të përbashkët të MBUMK nr. 780, datë 16.2.2012 të MF nr. 2478/1 datë 16.2.2012 me nr. 3, datë 16.2.2012, e cila përcakton se ... “Çdo disbursim është në përpjesëtim me masën e investimit të vetë përfituesit sipas fushës së investimit dhe shkallës përkatëse të financimit të përcaktuara në këtë udhëzim”.

-Pikën 1.2. të kontratës së huas datë 24.8.2012 lidhur midis palëve, në të cilën është përcaktuar se ... “huaja do të përdoret “Për blerjen e linjave të reja ose rinovimin e linjave ekzistuese të seleksionimit, të ruajtjes dhe përpunimit të gështenjës” dhe pikën 2.2. në të cilën është përcaktuar se ... “AZHBR kryen transferimin e shumës së aprovuar ... në përputhje realizimin e investimit përshkruar në biznes plan”.

Për sa cituam më sipër dhënia e (huasë), kredisë me vlerë 35,000,000 lekë përbën dëm ekonomik e cila duhet të arkëtohet nga subjekti “A...” sh.p.k.,

-Për subjektin “M...” sh.p.k. në shumën 2,193,476 lekë sa përfituar huanë sipas Urdhër shpenzimi nr. 209, datë 3.9.2013 për shumën 5,940,000 lekë, bashkëngjitur faturën tatimore nr. 7303, datë 16.8.2013 në vlerën 6,616,524 lekë dhe Urdhër shpenzimi nr. 353, datë 6.12.2013 për shumën 8,910,000 lekë, bashkëngjitur faturës tatimore nr. 7304, datë 23.8.2013 në vlerën 6,616,524 lekë në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 2.5.2013 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 239, datë 27.3.2013 “Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërpartit, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”, pika 6/f “Subjekti përfitues paraqet dokumentacionin e rregullt tatimor për investimin e kryer” pasi shuma e cila është me fatura tatimore është 12,656,524 lekë dhe diferenca me urdhër shpenzimet (14,850,000-12,656,524 = 2,193,476 lekë) është 2,193,476 lekë e cila është përfituar padrejtësisht dhe duhet të arkëtohet nga subjekti “M...” sh.p.k.

-Për subjektin “V...S...” sh.p.k. në shumën 12,000,000 lekë sa përfituar hua sipas urdhër shpenzimit nr. 207, datë 2.9.2013 bashkëngjitur listës së disbursimit faturës tatimore nr. 1018, datë 6.8.2013 në vlerën 16,008,240 lekë.

Komisioni i kontrollit sipas formulari të verifikimit dhe raportit të kontrollit datë 14.8.2013 del me konkluzionin se: “në subjektin “V...S...” është ndërtuar stalla për mbarështimin e derrave dhe ka filluar montimin e impjanteve dhe pajisjeve modernizuese në kompleksin e rritjes së derrit sipas biznesplanit të paraqitur” por nuk janë përcaktuar sasitë e materialeve sipas zërave të cilat janë montuar ose janë gjendje në subjekt dhe se sa është vlefte e tyre e cila do të disbursohet nga AZHBR. Nuk ka një preventiv ose situacion shpenzimesh të paraqitur nga aplikanti si për ngritjen e stallës së derrave ashtu edhe për pajisjet sipas faturës tatimore të paraqitur nga aplikanti. dhe faqen 2 pika 1, thuhet se rikonstruksioni i thertores nuk ka filluar akoma.

Komisioni i kontrollit sipas formulari të verifikimit dhe raportit të kontrollit për fazën e dytë datë 27.12.2013 del me konkluzionin: “nga verifikimi në teren i faturës me datë 6.8.2013 rezultoi se ka diferenca ndërmjet sasisë së deklaruar dhe gjetjeve faktike.....nuk plotëson kushtet për vazhdimin financimit...” .

Në këtë rast duhej që subjekti të kthente financimin sipas udhëzimit nr. 5, datë 2.5.2013 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 239, datë 27.3.2013 “Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërpartit, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit”, pika 7/5 “Kur përfituesi nuk plotëson kushtet e kontratës së

përcaktuar të lidhur mes palëve,.....devijon qëllimin e kredisë AZHBR-ja ka të drejtë të bllokojë disbursimin e kredisë së mbetur dhe të kërkojë kthimin e shumës së disbursuar deri në atë periudhë. Disbursimi i huasë në shumën e mësipërme është kryer pa dokumente që vërtetojnë se është kryer ndërtimi i stallës së re dhe subjekti “V...S...” sh.p.k ka përfituar padrejtësisht financimin (huanë) prej 12,000,000 lekë të cilën duhet ta arkëtojë.

-Për subjektin juridik “M...O...” sh.p.k. në shumën 4,840,000 lekë, sa përfituar hua për “përpunim, ruajtje dhe ambalazhim i vajit të ullirit” me urdhër shpenzimi nr. 221, datë 11.9.2013 për shumën 6,000,000 lekë, bashkëngjitur listën e disbursimit, faturës të thjeshtë tatimore nr. 6, datë 5.9.2013 në vlerën 1,160,000 lekë për katër copë cisterna Inox dhe katër faturave të thjeshta tatimore për rikonstruksione me situacionet përkatëse në vlerën 4,856,956 lekë. Urdhër shpenzimi duhej të ishte për shumën 1,160,000 lekë për Cisterna Inox pasi vlera tjetër është rikonstruksione të cilat i merr përsipër vetë subjekti sipas planit të biznesit të hartuar “kërkon financim në vlerën 15,000,000 lekë për makineri e pajisje shtesë të domosdoshme për dyfishimin e kapacitetit përpunues të një linje ekzistuese ndërsa fondet e tjera prej rreth 16 milion lekësh që nevojiten për ndërtimet e rikonstruksionet do të përballohen nga vetë firma”. Subjektit juridik “M...O...” sh.p.k ka përfituar padrejtësisht financimin (huanë) prej 4,840,000 lekë të cilën duhet ta arkëtojë.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI.

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **5,551,922 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, si më poshtë për:

1-Për 5 persona më shumën **68,621** lekë si më poshtë: R.U. për 13,122 lekë, Z.G. për 12,090 lekë, F.B. për 35,720 lekë, A.P. për 1,485 lekë dhe R.P. për 6,204 lekë për konsum karburantit më tepër se normativa e miratuar të cilat përbëjnë dëm ekonomik dhe duhet të arkëtohen.

Menjëherë

2-Studion “A...” sh.p.k. për shumën **50,000** lekë për mos zbatim të detyrimeve të kontratës me nr. 306, datë 9.5.2012, neni 1, UMF nr. 4363 datë 15.9.2011 “Për shpenzimet dhe koston ekonomike e procedurave të mbledhjes së detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondi kundër parti dhe non projekt grand aidi, të ardhura nga grandet Japoneze, për sektorin e bujqësisë e të ushqimit”, kreu III, pika 4; kreu IV, pika 1 dhe ligjit nr. 7850 datë 29.7.1994 “Për kodin civil”, i ndryshuar, kreu II, neni 476.

Menjëherë

3-Për subjektet “H...” sh.p.k., në vlerën **1,353,132** lekë, “Z...-P...” sh.p.k. në vlerën **3,265,082** lekë, dhe “Q...-S...” sh.p.k., në vlerën **815,077** lekë deri në momentin e auditimit 19.02.2014 nuk është llogaritur dhe kontabilizuar penaliteti 5% të detyrimit për çdo ditë vonesë, sipas kushteve të kontratës në kundërshtim me VKM 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, kap. I, pika 1 “Parime të përgjithshme”, rregullores së brendshme të AZHBR-së me nr. 660/1 prot., datë 4.9.2012, pika 7.3. vlerë e cila duhet të arkëtohet.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

-Mbështetur në kreu IV, neni 11, germa “e” dhe “ç” dhe nenin 37 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, i kërkojmë Drejtorit të AZHBR-së, Tiranë fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore, për punonjësit si më poshtë:

“largim nga puna”, për punonjësit e mëposhtëm:

1-z. K.T. përgjegjës i sektorit të menaxhimit të borxhit.

-Nuk janë kryer procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e detyrimeve nga **680 subjekte për shumën 1,278,893,647 lekë**, shkelje e kërkesave të kontratave të lidhur midis palëve, sipas Udhëzimit të përbashkët nr. 4160, datë 12.09.2006 i MBUMK dhe nr. 6829, datë 13.09.2006 të MF *“Për zbatimin e VKM nr. 555, datë 16.08.2006, për “Kthimin e Fondeve Financiare nga Subjektet, që Përfitojnë nga Përdorimi i Fondit Kundërpartit të Granteve Japoneze, Për Projektin “Rritja e Prodhimit Ushqimor 2KR”, dhe për një ndryshim në VKM nr. 479, datë 19.07.2001, nr. 373, datë 5.6.2003, dhe nr. 114, datë 25.02.2005, pika 14 e Udhëzimit nr. 2, datë 01.08.2008 për zbatimin e VKM nr.848, datë 11.06.2008 “Për Kthimin e Fondeve Financiare nga subjektet, që kanë përfituar nga përdorimi i Fondeve të Granteve Japoneze si mbështetje buxhetore “Non Project Grand Aid” (NPGA), për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit”, pika 3 e Urdhrit nr. 2, datë 16.01.2009 i MBUMK, dalë në mbështetje të VKM nr. nr. 1443, datë 31.10.2008 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si Agjencia e Pagesave”.*

-Për 15 subjektet: “A...”,” A...C”, “A...a”, “E...”,” S...A...”,” S...-L...”,” O...”,” A...i”, “F...”,” A...i”, “A...n”, “H...a”, “I...p”, “N...” dhe “K...” sh.p.k me vlerë detyrimi 367,630,954 lekë, për kontratat e lidhura sipas projektit 2KR në vitet 2007, 2008 dhe 2009, nuk është proceduar për sekuestrimin e tyre në kundërshtim me pikat 13, 14, 15 të Udhëzimit të përbashkët me nr. 4160, date 12.09.2006 i MBUMK dhe nr. 6829, datë 13.09.2006 të MF *“Për zbatimin e VKM nr. 555, datë 16.08.2006, për “Kthimin e Fondeve Financiare nga Subjektet, që Përfitojnë nga Përdorimi i Fondit Kundërpartit të Granteve Japoneze, Për Projektin “Rritja e Prodhimit Ushqimor 2KR”, dhe për një ndryshim në VKM nr. 479, datë 19.07.2001, nr. 373, datë 5.6.2003, dhe nr. 114, datë 25.02.2005, pika 14 e Udhëzimit nr. 2, datë 01.08.2008 për zbatimin e VKM nr.848, datë 11.06.2008 “Për Kthimin e Fondeve Financiare nga subjektet, që kanë përfituar nga përdorimi i Fondeve të Granteve Japoneze si mbështetje buxhetore “Non Project Grand Aid” (NPGA), për sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, pika 3 e Urdhrit nr.2, datë 16.01.2009 i MBUMK, dalë në mbështetje të VKM nr. nr. 1443, datë 31.10.2008 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, si Agjencia e Pagesave”.*

2. B.K. ish Drejtori i drejtorisë së kontrollit, pasi:

-Deklarimi nga komisioni i kontrollit për investimin e subjektit juridik “S...G” sh.pk. se *“investimi është në përputhje me kërkesat e udhëzimit për përfitueshmërinë”* nuk qëndron pasi ky vlerësim është kryer jo në përputhje me manualin e procedurave për përfituesit e fondit kundërpartit *“Drejtoria e kontrollit; ekipi i kontrollit ndjek procedurën; tërheq nga DEP dokumentacionin përkatës, studion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në dosje, bën kontrollin në terren ...në verifikimin e fakteve në përputhje me biznesplanin....”.*

-Deklarimi nga komisioni i kontrollit për investimin e subjektit juridik “V...S...” sh.p.k. se: *“në subjektin “V...S...” është ndërtuar stalla për mbarështimin e derrave dhe ka filluar montimin e impianteve dhe pajisjeve modernizuese në kompleksin e rritjes së derrit sipas biznesplanit të paraqitur”* është në kundërshtim me manualin nr. 638, datë 31.5.2013 *“Manuali i procedurave për implementimin e skemave kombëtare”* aneksi *“Shtesë e manualit të procedurave për implementimin e skemave kombëtare të vitit 2013”*, drejtoria e kontrollit; *“Ekipi i kontrollit studion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në dosje (aplikimin, kërkesat për pagesë, biznes planin, akt marrëveshjen e nënshkruar, raportet e kontrolleve të mëparshme etj”, bën kontrollin në terren verifikimin e fakteve në përputhje me biznesplanin dhe fazën në të cilën ndodhet investimi...”.*

-Formulari i verifikimit dhe raporti i kontrollit datë 6.9.2013 për subjektin juridik “M...o...” sh.p.k me konkluzionin: *“nga kontrolli i zbatimit të biznesplanit dhe situacionit të dërguar nga DEP, rezulton se investimi është në përputhje me biznesplanin, punimet janë në proces”* nuk është në zbatim të manualit nr. 638, datë 31.5.2013 *“Manuali i procedurave për implementimin e skemave kombëtare”* aneksi *“Shtesë e manualit të procedurave për implementimin e skemave kombëtare të vitit 2013”*, drejtoria e kontrollit; *“Ekipi i kontrollit*

studion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në dosje (aplikimin, kërkesat për pagesë, biznes planin, akt marrëveshjen e nënshkruar, raportet e kontrolleve të mëparshme etj), ‘Bën kontrollin në terrennë verifikimin e fakteve në përputhje me biznesplanin dhe fazën në të cilën ndodhet investimi...’.

3-R.V. juriste, pasi:

-Sipas raportit të vlerësimit i paraqitur nga “A...” sh.p.k sipërfaqja “Truall” 5028 m² sipas vlerës së tregut është 15,084,000 lekë dhe zë 37% e vlerës totale të huasë (15,048,000 : 40,000,000=37%) në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 10.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve specifike të shpërndarjes të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit , në zbatim të VKM nr. 239, datë 27.3.2012 pika IV Të tjera: “vendosja e barrës së shkallës së dytë, do të pranohet vetëm në ato raste kur vlera e kolateralit, sipas vlerësimit të eksperteve është jo më pak se 150% e vlerës totale të huave për të cilat është vendosur prona si kolateral (përfshirë edhe huanë nga Fondet Kunderparti) dhe nuk ka pengesa ligjore për vendosjen e kësaj barre”.

-Në dosjen e aplikantit “E.A.” nuk ndodhet sigurimi i pronës “Rezervat peshku” nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi e cila është përdorur si kolateral në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 2.5.2013 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 239, datë 27.3.2013 “Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit” pika 6/c: “Subjekti bën sigurimin e pronës nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi”.

-Për subjektin juridik “M...” sh.pk shuma totale e huasë është (14,850,000 lekë + 80,000,000 lekë = 94,850,000 lekë) kur sipas raportit të vlerësimit sipërfaqja “Truall” për 26,264 m² e përdorur si kolateral sipas vlerës së tregut është 120,772,750 lekë e cila zë 127% e vlerës totale të huasë (120,772,750 : 94,850,000 =127%) në kundërshtim me udhëzimin nr. 6, datë 10.5.2013 “Për përcaktimin e kriterëve specifike të shpërndarjes të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit , në zbatim të VKM nr. 239, datë 27.3.2012. pika IV, Të tjera: “vendosja e barrës së shkallës së dytë, do të pranohet vetëm në ato raste kur vlera e kolateralit, sipas vlerësimit të eksperteve është jo më pak se 150% e vlerës totale të huave për të cilat është vendosur prona si kolateral (përfshirë edhe huanë nga Fondet Kunderparti) dhe nuk ka pengesa ligjore për vendosjen e kësaj barre” dhe manualin e procedurave për fondet kundërparti; detyrat e sektorit juridik “Përgatitjen e dokumentacionit ligjor, për vendosjen e barës siguruese mbi pasurinë që do të shërbejë si kolateral dhe ndjekjen dhe zbatimin e këtij procesi....”.

-Në dosjet e aplikantëve të cilët kanë përfituar (hua) gjatë vitit 2012 nuk ndodhet sigurimi i pronës nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi e cila është përdorur si kolateral pasi ka përfunduar afati një vjeçar i tyre, kjo në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 2.5.2013 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 239, datë 27.3.2013 “Për miratimin e mënyrës së re të përdorimit të fondeve kundërparti, të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit” pika 6/c: “Subjekti bën sigurimin e pronës nga rreziqet pranë një shoqërie sigurimi”.

“Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, për punonjësit e mëposhtëm:

1-J.Sh., anëtare e Komisionit të Vlerësimit dhe Miratimit të huasë, pasi:

-Nga auditimi i dosjeve të aplikantëve që përfitojnë nga fondet kundërparti të mbledhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë dhe të ushqimit në formën e kredive pa interes me qëllim nxitjen dhe rritjen e prodhimit bujqësor dhe blegtoral, duke mos pasur dokumentacionin e plotë të kërkuar dhe duke mos respektuar procedurat për përfitimin sipas udhëzimeve janë kualifikuar për përfitimin e huasë, për vitin 2012 tre subjekte në shumën 55,000,000 lekë dhe për vitin 2013 gjashtë subjekte në shumën 75,292,500 lekë.

2-S.M. me detyrë përgjegjëse i Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave, pasi:

-Ka lejuar kryerjen e pagesës për dhënien e kredisë, huas, për vitet 2012 dhe 2013 për gjashtë subjekte të cilët kanë përfituar padrejtësisht shumën **65,535,476** lekë. Në kundërshtim me udhëzimin nr. 5, datë 2.5.2013, udhëzimin nr. 3, datë 16.2.2012.

3- Antarët e komisionit të Kontrollit G.S., R.P., A.Ç., N.H., A.A., dhe V.K., pasi:

-Deklarimi nga komisioni i kontrollit për investimin e subjektit juridik "S..." sh.pk. se *"investimi është në përputhje me kërkesat e udhëzimit për përfitueshmërinë"* nuk qëndron pasi ky vlerësim është kryer jo në përputhje me manualin e procedurave për përfituesit e fondit kundërparti *"Drejtoria e kontrollit; ekipi i kontrollit ndjek procedurën; tërheq nga DEP dokumentacionin përkatës, studion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në dosje, bën kontrollin në terren ...në verifikimin e fakteve në përputhje me biznesplanin...."*.

-Deklarimi nga komisioni i kontrollit për investimin e subjektit juridik "V...S..." sh.p.k. se: *"në subjektin "V...S..." është ndërtuar stalla për mbarështimin e derrave dhe ka filluar montimin e impianteve dhe pajisjeve modernizuese në kompleksin e rritjes së derrit sipas biznesplanit të paraqitur"* është në kundërshtim me manualin nr. 638, datë 31.5.2013 *"Manuali i procedurave për implementimin e skemave kombëtare"* aneksi *"Shtesë e manualit të procedurave për implementimin e skemave kombëtare të vitit 2013"*, drejtoria e kontrollit; *"Ekipi i kontrollit studion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në dosje (aplikimin, kërkesat për pagesë, biznes planin, akt marrëveshjen e nënshkruar, raportet e kontrolleve të mëparshme etj)", bën kontrollin në terren verifikimin e fakteve në përputhje me biznesplanin dhe fazën në të cilën ndodhet investimi..."*.

-Formulari i verifikimit dhe raporti i kontrollit datë 6.9.2013 për subjektin juridik *"Musaj olive"* sh.p.k me konkluzionin: *"nga kontrolli i zbatimit të biznesplanit dhe situacionit të dërguar nga DEP, rezulton se investimi është në përputhje me biznesplanin, punimet janë në proces"* nuk është në zbatim të manualit nr. 638, datë 31.5.2013 *"Manuali i procedurave për implementimin e skemave kombëtare"* aneksi *"Shtesë e manualit të procedurave për implementimin e skemave kombëtare të vitit 2013"*, drejtoria e kontrollit; *"Ekipi i kontrollit studion të gjithë dokumentacionin e disponueshëm në dosje (aplikimin, kërkesat për pagesë, biznes planin, akt marrëveshjen e nënshkruar, raportet e kontrolleve të mëparshme etj)", 'Bën kontrollin në terrennë verifikimin e fakteve në përputhje me biznesplanin dhe fazën në të cilën ndodhet investimi..."*.

Shënim:

a). Për ish-drejtuesit nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit të tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte ***"largim nga puna"*** përkatësisht.

1. Gj.V. me detyrë ish drejtor i AZHBR-së:

2. L.I. me detyrë ish drejtor i Drejtorisë së Pagesave,

3- D.K. me detyrë specialiste e Sektorit të Menaxhimit të Borxhit:

4. E.A. me detyrë juriste

5. N.Gj. me detyrë jurist.

6-Komisionin e Vlerësimit dhe Miratimit: R.F. kryetar, R.L. anëtar, R.U. anëtar Sh.H. anëtar, dhe A.M. anëtar.

Për drejtuesit e mësipërm të njoftohet Departamenti i Administratës Publike për masat disiplinore me qëllim kryerjen e regjistrimeve të nevojshme në Regjistrin Qendror të Personelit.

Nga AZHBR me shkresë nr.1877, prot, datë 13.06.2014, protokolluar në KLSH me nr.31/10 datë 17.06.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e

rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Bexhet Zeqiri, Jilian Adili, Josif Lile dhe Mirland Çela, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT